

Premium Finance Invest
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCES	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 15

Premium Finance Invest

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2018**

	Shënim	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	3,653	19,922,047
Total aktive afatshkurtra		3,653	19,922,047
Aktivet afatgjata			
Parapagime për blerje asetesh	5	94,407,500	-
Total aktive afatgjata		94,407,500	-
Total aktive		94,411,153	19,922,047
DETÝRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Hua afatshkurtra	6	6,221	1,118
Llogari të pagueshme tregtare	7	525,018	50,800
Detyrime tatimore	8	114,812	6,975
Të tjera detyrime	9	1,762,611	447,281
Total detyrime afatshkurtra		2,408,662	506,174
Detyrime afatgjata			
Hua afatgjata	10	74,669,100	-
Total detyrime afatgjata		74,669,100	-
Totali i detyrimeve		77,077,762	506,174
Kapitali	11		
Kapitali i nënshkruar		20,000,000	20,000,000
Rezerva të tjera		(584,127)	130,745
Fitimi i ushtrimit		(2,082,482)	(714,872)
Total kapitali		17,333,391	19,415,873
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		94,411,153	19,922,047

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	12	(27,853)	(341,658)
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(855,690)	(19,099)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		-	-
2) Të tjera shpenzime	13	(855,690)	(19,099)
Shpenzime të personelit	14	(1,219,216)	(342,876)
1) Paga dhe shpërblime		(1,120,920)	(300,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore		(98,296)	(42,876)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit		-	(11,127)
Të ardhura të tjera		-	-
Shpenzime financiare	15	20,277	(112)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(436,835)	(112)
2) Shpenzime të tjera financiare		457,112	-
Fitimi/humbja para tatimit		(2,082,482)	(714,872)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	16	-	-
Fitimi/humbja e vtitit		(2,082,482)	(714,872)
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(2,082,482)	(714,872)

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Premium Finance Invest

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018


	Kapitali i nënshkruar	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vtitit	Totali
Pozicioni finansiar më 31 dhjetor 2016	20,000,000	-	130,745	2,654,137
Fitimi / Humbja e vtitit			(714,872)	(714,872)
Lëvizjet përmes kapitalit		130,745	(130,745)	-
Pozicioni finansiar i më 31 dhjetor 2017	20,000,000	130,745	(714,872)	19,415,873
Fitimi / Humbja e vtitit			(2,082,482)	(2,082,482)
Lëvizjet përmes kapitalit		(714,872)	714,872	-
Pozicioni finansiar më 31 dhjetor 2018	20,000,000	(584,127)	(2,082,482)	17,333,391

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë:



Martin Max Ulrich Streibl
Administrator



Mazars Shpk

Mazars shpk
Hartues i Pasqyrave



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018**

	Shënimë	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		(2,082,482)	(714,872)
Shpenzimet financiare jomonetare		(429,259)	341,658
Rritje/(rënje) në detyrimet e pagueshme		1,001,661	100,690
Rritje/(rënje) në detyrime për punonjësit		895,724	270,976
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(614,356)	(1,548)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(94,407,500)	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(94,407,500)	-
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Hua të arkëtuara		74,674,203	-
Pagesa e huave		-	813
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		74,674,203	813
Rritje/(rënje) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(20,347,653)	(735)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		19,922,047	20,264,440
Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare		429,259	(341,658)
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	4	3,653	19,922,047

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 15, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Premium Finance Invest është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar datë 14/04/2016 në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare".

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 20.000.000 Lek (katër million lek), i ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 20.000.000 Lek.

Ortakët e shoqërisë janë Power Invest, zotëruese e 1 kuote ose 100 % të kapitalit të shoqërisë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është: "kryerja e çdo veprimtarie apo aktiviteti tregtar të ligjshëm në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Në mënyre me specifike, Shoqëria do të mund te kryeje çdo aktivitet të ligjshem tregtar import, eksporti, tregtia me shumicë e pakicë të mallrave, çdo aktivitet që lidhet me çfarëdolloj pasurie të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, duke përfshirë por pa u kufizuar vetem në blerjen, shitjen, transferimin, ndërtimin, nën-kontraktimin, disponimin, posedimin, menaxhimin, marrjen apo dhënien me qira, leasing e pasurive të luajtshme dhe/ose të paluajtshme, dhënien e fitimin e çdo te drejtë apo privilegji në lidhje me këto pasuri.". Aktiviteti i shoqërise është me afat të pacaktuar.

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Brigada VIII, ndërtesa nr 6, hyrja nr.7, apartamenti 1, Tiranë. Ajo është regjistruar në Degën e Tatimeve të rrethit Tiranë me NIPT L61711009G.

Më 31 dhjetor 2018 Shoqëria kishte 1 punonjës.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr. 64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 12 Shkurt 2016.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitura e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në daten e pasqyrës së pozicionit finanziar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimesht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjera duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësimet bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizonet

Provizonet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Sic paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.15, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përvèc rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare sic kërkohet nga Standardized Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2018:

Kursi i këmbimit	2018	2017
Euro/LEK	123.42	132.95
USD/ LEK	107.82	111.10
GBP/LEK	137.42	149.95

3.2. Instrumentat finanziarë

Instrumentat finanziarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat finanziarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njojjes fillestare instrumentat finanziarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument finansiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet finanziare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finansiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve finanziare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet finanziare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitet financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij finansiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizonit llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njojjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njojur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferençë midis kostos dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë përiudhës së huamarries duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njoitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferençë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuase. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2018 dhe 2017 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëherëshme dhe zbritjet e bëra për sasi (vêllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përvèç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesii njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatimi fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përvèç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatemore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2018 eshte 0% .

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferençën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferençat e përkohshme që krijojnë për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatemore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatemore në fuqi mbi diferençën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatemore.

Gjendjet e shtyra tatemore maten me normat tatemore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferençat e përkohshme do të anullohen ose humbja tatemore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatemore të shtyra për diferençat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridikcionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizonet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen fluksete dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizonet përcaktohen duke skontuar fluksete përshtime të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe përisqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizonet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizonet rimerren.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financier dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Mjete monetare në bankë	3,653	19,922,047
Mjete monetare në arkë	-	-
Total	3,653	19,922,047

5. Parapagime për blerje asetesh

Parapagimet për blerjen e aseteve në 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Parapagim për blerje asete	94,407,500	-
Total	94,407,500	-

6. Hua afatshkurtra

Huatë afatshkurtra më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Overdraft	6,221	1,118
Total	6,221	1,118

7. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2018 detajohen simë poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Furnitorë vendas	525,018	50,800
Total	525,018	50,800

Premium Finance Invest
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lek)

8. Detyrime tativore

Detyrimet tativore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Kontributë për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	39,557	6,975
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	75,255	-
Total	114,812	6,975

9. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2018 si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Pagat e punonjësve	1,236,426	340,702
Te tjera detyrime	526,185	106,579
Total	1,762,611	447,281

10. Hua afatgjata:

Huatë afatgjata më 31 dhjetor 2018 detajohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Financim nga WSI	74,669,100	-
	74,669,100	-

11. Kapitali

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 20.000.000 Lek i zotëruar 100% nga Power Invest. Gjatë vitit 2018 nuk ka pasur ndryshime në strukturën e kapitalit të shoqërisë. Shoqëria ka rezultuar me humbje (2,082,482) Lek gjatë vitit 2018.

12. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Humbje nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	(27,853)	(341,658)
Fitim nga këmbimet valutore nga aktiviteti i shfrytëzimit	-	-
Total	(27,853)	(341,658)

Premium Finance Invest
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lek)

13. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për konsulencë ekonomike	720,213	-
Shpenzime bankare	64,610	6,599
Shpenzime udhëtimesh	43,582	-
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	15,785	-
Taksa vendore	7,500	12,500
Materiale konsumi	4,000	-
	855,690	19,099

14. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime për pagë	1,120,920	300,000
Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	98,296	42,876
Total	1,219,216	342,876

Numri i punonjesve më 31 dhjetor 2018 është 1.

15. Shpenzime Financiare

Shpenzimet financiare per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 janë detauar si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Shpenzime interesë	(436,835)	(112)
Fitim nga këmbimet valutore	457,741	-
Humbje nga këmbimet valutore financiare	(629)	-
Total	20,277	(112)

Premium Finance Invest
 Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
 (Vlerat janë në Lek)

16. Tatimi mbi fitimin

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Fitimi para tatimit	(2,082,482)	(714,872)
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	26,678	-
Shpenzime për interesa mbi normën tatumore	26,678	-
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	(2,055,804)	(714,872)
Humbje fiskale e mbartur		-
Fitimi Para Tatimit	(2,055,804)	(714,872)
Tatim fitimi 0%	-	-
Fitimi i vitit	(2,082,482)	(714,872)

17. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin finansiar të shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2018 shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkoje rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

18. Ngjarje pas datës së Bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.